

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Auditim
Me zgjidhje

P6

Data 16/06/2018

Detyra 1

AGA-trans është klient i firmës tuaj të auditimit. Kompania është ballafaquar me vështirësi të mëdha në vitet e fundit. Puna e auditimit në terren për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 tashmë ka përfunduar. Në vijim janë paraqitur çështjet si rezultat i punës së auditimit:

(i) AGA-trans ka shkelur kushtet e kredisë së bankës. Menaxhmenti ka treguar se ka mbajtur një takim me bankierët e kompanisë në të cilën janë siguruar nga banka se kredia dhe mbitërherqja nuk do të tërhiqen (ndërpriten) nga banka. AGA-trans ka një kredi pesë-vjeçare prej €600,000 dhe një mbitërheqje (overdraft) në vlerë prej €250,000.

(ii) AGA-trans ka një investim financiar prej €50,000 në një kompani të quajtur Vita Shpk. Vita Shpk nuk kualifikohet për tu trajtuar si degë e AGA-trans. Klienti (AGA-trans) nuk ishte në gjendje të ofronte dëshmi për të mbështetur vlerën bartëse të investimit në Vita. Shifrat draft të AGA-trans për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017 paraqesin të hyra prej €9.5 milion, humbje para tatimit prej €500,000 dhe pasuri neto prej €2.5 milion. Nuk ka çështje tjera që janë vërejtur gjatë auditimit.

Kërkohet:

(a) Shkruani një memo për partnerin e auditimit në të cilën paraqitet se çfarë dëshmi të auditimit duhet të përftohen lidhur me çështjet e mësipërme dhe gjithashtu duke treguar ndikimin që kanë në raportin e auditimi. (12 pikë)

(b) Në takimin planifikues për këtë angazhim, partneri i auditimit vërejtë se raporti i auditimit që ishte draftuar nga seniori i auditimit ishte mjaft i varfër. Rekomandoni një numër të kontrolleve që duhet të kryhen para se raporti të nënshkruhet për tu siguruar se raporti është në pajtueshmëri me standardet e auditimit. (5 pikë)

(c) Sipas SNA 706 – *Paragrafët e theksimit të çështjes dhe paragrafët e çështjeve tjera në një raport të auditorit të pavarur*, listoni tri raste të cilat mund të rezultojnë me një paragraf të “theksimit të çështjes”. (3 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Memo për: Partnerin e auditimit

Nga: Seniori i auditimi

Re: AGA-trans

(1 pikë formati i raportit)

Në vijim është dëshmia e auditimit që na nevojitet dhe implikimet që i parashikoj lidhur me opinionin e auditimit lidhur me çështjet e paraqitura të kompanisë:

(i) Shkelja e kushteve të kontratës së kredisë

Mënaxhmenti ka treguar se është siguruar nga banka se nuk do ta tërheqin as kredinë as mbitërheqjen. Me aprovim të klientit, kisha kërkuar që këtë pohim ta bëjë vetë banka në formë të shkruar. Nëse e pranojmë një konfirmim të tillë, kjo do të përbënte bazë për konkluzionin tonë nëse entiteti është duke operuar sipas hipotezës së vijimësisë. Pasuria neto e kompanisë është €2.5 milion. Nëse kompania do të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë varet nga kapitali qarkullues i kompanisë i cili duhet të hetohet më tutje. Nëse hetimi ynë jap rezultate positive, atëherë çështja nuk do të ketë implikime në raportin tonë të auditimit.

Nëse nuk pranohet konfirmim nga banka atëherë problemi me vijimësinë do të ekzistojë dhe kërkon konsiderim të mëtutjeshëm.

Nëse pas analizave tona vijmë në përfundim se pasqyrat financiare janë përgatitur sipas bazës së hipotezës së vijimësisë dhe pasqyrat përfshijnë shpalojet e duhura, atëherë duhet të përfshihet një paragraf shtesë në raportin e auditorit që i referohet shpalosjes përkatëse.

Nëse konsiderojmë se shpalosja është e pamjaftueshme por entiteti vijon sipas hipotezës së vijimësisë, atëherë opinionin duhet të rezervohet me 'përveç për' çështjen që është në mosmarrveshje me menaxhmentin e kompanisë si dhe duke përfshirë paragrafin shpjegues lidhur me pasigurinë materiale për hipotezën e vijimësisë.

Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e hipotezës së vijimësisë mirëpo ne si auditor nuk pajtohemi me këtë bazë, efekti i kësaj çështje është materiale dhe përhapëse prandaj ne duhet të japim një opinion kundër.

(ii) Vlera bartëse e investimit

Kompania nuk mund të ofrojë dëshminë e kërkuar për vlerën bartëse të investimit në Vita Shpk. Ne duhet të shohim nëse ka ndonjë dëshmi alternative që mund të përdoret për të mbështetur vlerën bartëse. Duhet të përpiqemi të marrim pasqyrat financiare të vitit të kaluar të lëshuara nga Vita Shpk dhe të rishikojmë pasuritë neto në pasqyrën e pozicionit financiar të saj. Nëse nuk ka dëshmi alternative në dispozicion, atëherë kjo përbën kufizim të objektit të auditimit. Vlera maksimale për tu shlyer është €50,000, e cila vlerë do të zvogëlonte pasuritë neto të kompanisë dhe do të riitë humbjen për atë shumë. Duke marrë parasysh që kompania është duke generuar humbje, mund të thuhet se shumica është materiale dhe mund të çojë në opinion me rezervë me "përveç për".

(8 marks)

Rezervimi

Dëshmitë në dispozicion janë të limituara prandaj ne nuk mund të përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me vlerën bartëse të investimit në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerë prej €50,000. Çfardo korrigjimi në këtë shumë do të ketë efekt në humbjen e kompanisë. Ka pak gjasë që të përftojë dëshmi alternative për shumë.

Opinion me rezervë për shkak të kufizimit të objektit të auditimit.

(c) Në vijim janë kontrollet që duhet të kryhen para se të nënshkruhet raporti i auditimit

- Sigurohoni që referencat ligjore janë të sakta
- Sigurohuni që referencat e faqeve ne raport përputhen me faqet e pasqyrave financiare,
- Rezultati i saktë është parqitur në paragrafin e opinionit
- Sigurohuni se ka konsistencë të paraqitjes së PF me SNRF,
- Kontrolloni emrin e kompanisë dhe vitet e raportimit,
- Sigurohuni se opinionit i auditimit përputhet me evidencat mbështetëse,
- Sigurohuni që raporti i drejtohet personave të duhur, psh drejtorëve, menaxhmentit, bordit, etj (5 marks)

(d)

Shembuj të rrethanave kur auditori konsideron përfshirjen e paragrafit të theksimit të çështjes:

- Pasguri lidhur me rezultatet e ardhshme të një çështje ligjore ose veprimi nga rregullatorët.
- Zbatimi i hershëm (nëse lejohet) i ndonjë standardi të ri të kontabilitetit (SNRF) i cila ka efekt përhapës në pasqyrat financiare
- Ndonjë katastrofë e madhe e cila ka pasur, ose vazhdon të ketë, efekt në pozitën financiare të entitetit.

Detyra 2

Ju jeni auditor i jashtëm i CS Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2017. CS operon me 12 dyqane në tërë teritorin e Prishtinës:

- Secili dyqan shet ushqim dhe e ka sektorin e kuzhinës.
- Secili dyqan është përgjegjës për blerjen e stokeve të veta dhe e prodhon një raport menaxherial mujor që dërgohet në departamentin e centralizuar të kontabilitetit në zyrat kryesore të CS.

CS financohet nga një kredi bankare në vlerë prej €250,000 që është e pagueshme me një vlerë vjetore prej €50,000 në pesë vitet e ardhshme duke filluar nga data 31 korrik 2017. Kompania gjithashtu ka një mbitërheqje bankare prej €100,000 e cila është përdorur në tërësi. Mbitërheqja duhet të rinovohet me 1 prill 2018.

Banka tashmë i ka kërkuar kompanisë të përgatisë rrjedhën e parashikuar të parasë për dy vite duke filluar nga 1 shkurt 2018 në mënyrë që banka të vendos nëse mund t'i rinovohet mbitërheqja.

Banka gjithashtu ka kërkuar një raport nga auditorët e jashtëm për të konfirmuar saktësinë e parashikimit të parasë.

Kërkohe:

(a) Përkufizoni termin 'procedura analitike' (3 pikë)

(b) Lidhur me punën e auditorit të jashtëm:

- (i) Përshkruani KATËR procedura analitike që mund të kryhen për të konfirmuar të hyrat dhe fitimin e kompanisë CS. (4 pikë)
- (ii) Përshkruani procedurat thelbësore (të pavarura) që duhet të kryhen për të verifikuar pohimet në vijim:
 - Vlerësimi i stokeve. (5 pikë)
 - Plotësia e të pagueshmeve. (4 pikë)
- (iii) Rekomandoni procedurat e pavarura që duhet të kryhen për të konfirmuar kreditë dhe huatë nga banka të CS. (4 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a) Procedurat analitike përfshijnë vlerësimin e informatave financiare dhe jofinanciare dhe krahasimin e rezultateve aktuale me ato të pritshme. Ato gjithashtu përfshijnë identifikimin e luhatjeve domethënëse dhe marrëdhënieve që devijojnë nga pritjet. Pritjet duhet të zhvillohen duke u bazuar në njohurinë e auditorit për aktivitetet e kompanisë gjatë periudhës që auditohet dhe informatave të përftuara gjatë kryerjes së testeve tjera të auditimit.

(b)

(i) Katër procedura analitike

- Rishikimi i shitjeve mujore sipas produkteve ushqimore, dhe të hyrave nga kuzhina.
- Krahasimi i marzhave të shitjeve në të gjitha dyqanet
- Rishikimi i marzhës së fitimit dhe krahasimi me të hyrat
- Rishikimi i nivelit mesatar të stoqeve në dyqane
- Krahasimi i niveleve aktuale të shitjeve për dyqan me buxhetet

(ii) Procedurat thelbësore (1 pikë secila)

Vlerësimi i stoqeve

Verifikimi i një mostre të faturave të furnitorëve për të vërtetuar koston

Diskutimi i përafrimit të kostove me meaxhmentin dhe krahasimi me çmimet aktuale

Ekazminimi i çmimeve të shitjes pas fundit të vitit për të konfirmuar se $VNR >$ se kosto e stoqeve

Ndjekja e një mostre të artikujve të stoqeve që mbahen në dyqane deri te faturat e blerjes për të konfirmuar koston

Konsideroni nivelin e stoqeve që prishen dhe ju skadon afati i përdorimit gjatë numërimit fizik të stqeve për të përcaktuar vlerën e tyre

Plotësia e të pagueshmeve

Krahasimi i niveleve të të pagueshmeve nga viti në vit

Konfirmimi i llogarive të pagueshme dhe rishikimi i kartelave të furnitorëve

Rishikimi i librit të parasë për pagesa ndaj furnitorëve pas fundit të vitit

Llogaritja e ditëve në llogarive të pagueshme dhe hetimi i çfardo ndryshimi domethënës

(iii) Huaja bankare

Inspektimi i marrëveshjes për kredi për të vërtetuar shumën e huazuar dhe kushtet specifike të kredisë

Përftoni konfirmimin direkt bankar nga banka

Sigurohuni se kredia është ndarë si duhet në pjesën afatgjatë dhe afatshkurtë

Sigurohuni se shpenzimet e interesit janë regjistruar si duhet

Detyra 3

Ju jeni auditor junior dhe sapo ju kanë angazhuar në auditimin e Furra Xerxa, një kompani e mesme me seli në Xërxë.

Ju jeni përgjegjës për një numër të fushave të auditimit duke përfshirë edhe pasuritë joqarkulluese. Partneri i auditimit ju ka informuar se Furra e ka zgjeruar ndërtesën e prodhimit këtë vit si dhe ka investuar mjaft në pajisjet e reja të furrës. Prandaj, edhe pse në të kaluarën auditorët i kanë testuar shtesat në llogarinë e pasurive joqarkulluese përmes testeve të pavarura, partneri ka kërkuar që ekipi i auditimit të kuptojë dhe dokumentojë proceset dhe kontrollet në këtë fushë në mënyrë që të vlerësohet nëse ka ndonjë mangësi në kontrolle.

Njëri nga anëtarët e ekipit të auditimit javën e kaluar ka vizituar Furrën dhe ka dokumentuar procesin e shtesave (blerjeve) të pasurive joqarkulluese në dokumentin e punës mëposhtë.

Dokument pune: Kontrollet mbi shtesat e pasurive joqarkulluese

Përgatitur nga: Auditori

Klienti: Furra Xerxa

Viti që përfundon me: 31 dhjetor 2017

Furra e mban një regjistër të pasurive joqarkulluese në të cilin përfshihen detajet si kodi i artikullit, numri, kosto dhe viti i blerjes i këtyre pasurive. Kur këkohet ndonjë pasuri e re (siç është mikseri i ri ose ndonjë furrë) bukëpjekësit e diskutojnë këtë me pronarin e kompanisë dhe se bashku plotësojnë formën e kërkesës së artikullit me përshkrimin e duhur.

Në bazë të kërkesës plotësohet porosia e cila nënshkruhet nga personeli i kontabilitetit. Të gjitha format e porosisë janë të paranumëruara.

Në rastet kur një artikull kërkohet të zëvendësohet, siç janë shportat e bukës, bukëpjekësit po ashtu plotësojnë kërkesën për blerje. Personi i cili e bënë kërkesën duhet të ofrojë kodin e artikullit (që gjendet në regjistrin e pasurive), përshkrimin dhe numrin e artikujve të ri që kërkohen dhe poashtu arsyen e kërkesës (zëvendësim, thyerje, etj). Pasi që bukëpjekësit punojnë në mes të orës 12 në mesnatë dhe 6 në mëngjes, nuk është gjithmonë e mundur të merren të gjitha detajet nga zyra prandaj në shumë raste kjo pjesë e formës mbetet e zbrazët.

Pastaj nga kërkesa bëhet porosia nga personeli i kontabilitetit. Të gjitha porositë janë të paranumëruara. Porosia pastaj aprovohet nga pronari/menaxheri i furrës duke e rishikuar seksionin e porosisë në të cilin paraqiten arsyet e zëvendësimit. Nuk bëhet ndonjë inspektim fizik mbi pasuritë që duhet të zëvendësohen.

Pas aprovimit, një kopje e porosisë dërgohet të nëpunësi i kontabilitetit i cili i porositë artikujt nga furnitori përkatës. (Shënim: nëpunësi i kontabilitetit nuk mund të kryej porosi pa pasur edhe formën e kërkesës). Detajet e formës origjinale të porosisë futen në listën e porosive në pritje. Lista e porosive në pritje rishikohet sipas nevojës, nëse personeli i furrës pyet pse një porosi nuk është përmbushur/pranuar.

Pas pranimit të artikujve, përgatitet një fletë-pranim i mallit nga departamenti i pranimit dhe përputhet me porosinë origjinale. Mallrat nuk pranohen nëse nuk ka të dhëna të tilla në porosi. Fletë-pranimet nuk janë të paranumëruara. Pasi që mallrat/artikujt janë pranuar, edhe fletë-porosi edhe fletë-pranimi dërgohen te nëpunësi i kontabilitetit. Format e përputhura mbahen nga nëpunësi i kontabilitetit i cili do t'i përdor ato për të përputhur me faturën përkatëse kur ajo pranohet më vonë.

Nëpunësi i kontabilitetit regjistron blerjet e mallrave në sistem duke debituar pasuritë joqarkulluese dhe duke kredituar llogaritë e pagueshme pasi që pranohet fatura dhe përputhet me fletëpranim dhe fletëporosi. Kjo zakonisht bëhet në baza javore me grumbull të faturave. Gjithashtu azhurnohet edhe regjistri i pasurive joqarkulluese me shtesat (blerjet) përkatëse. Nëse ka mospërputhje në mes të

fletë-pranimi dhe faturës përkatëse, fatura regjistrohet në sistem dhe korrigohet më vonë, pasi që zgjidhet çështja e mospërputhjes. Çdo muaj bëhet harmonizimi i regjistrit të pasurive joqarkulluese me pasuritë joqarkulluese nga libri kryesor të blera gjatë muajit dhe ky harmonizim aprovohet nga drejtori financiar. Rrallë ka ndonjë diferencë që paraqitet në harmonizim.

Kërkohe:

(a) Nga dokumentimi i proceseve të kontrollit mbi blerjet/shtesat e pasurive joqarkulluese të praqitura më sipër, përshkruani dobësitë domethënëse në kontrolle. (5 pikë)

(b) Në këtë letër përfshini vlerësimin e ndikimit të secilës dobësi dhe rekomandoni përmirësimin e tyre. (10 pikë)

(c) Cilat janë qëllimet e testeve të kontrollit? (2 pikë)

(d) Përshkruani shembuj të kontrolleve efektive në aktivitetet e Furrës Xërxa. (3 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Për: Menaxhmentin e kompanisë

Nga: Auditorët

Tema: Dobësitë në kontrolle për shtesta/blerjet e pasurive joqarkulluese

Dobësitë në kontrolle

Edhe pse menaxhmenti e rishikon arsyen e zëvendësimit të ndonjë artikulli, arsyeja nuk validohet

Format e kërkesës për blerje mund të mos jenë të plota
Mallrat e porositura mund të mos pranohen

Nuk kryhet inspektimi fizik i pasurive të blera

Format e fletëpranimeve nuk janë të pranumëruara

Detajet e blerjes së një pasurie regjistrohen vetëm kur pranohet fatura

Nëse ka mospërputhje në mes të fletëpranimit dhe faturës, kjo korrigjohet më vonë

Ndikimi i dobësisë

Kjo mund të rezultojë me posositje për zëvendësim të ndonjë artikulli që nuk ka nevojë

Kjo rezulton me blerje jo të plota dhe të panevojshme

Nuk ka ndjekje të vazhdueshme të porozive dhe pranimi të tyre përveç nëse dikush kërkon arsyen. Kjo mund të shkaktojvonesa në prodhim nëse artikujt nuk vijnë me kohë

Për shkak të mugesës së ndarjes së detyrave në mes të atyre që porosisin pasuritë dhe atyre që kanë qasje mbi pasuri, ka rrezik të keqpërdorimit të pasurive.
Detyrimet për mallrat e porositura mund të mos identifikohen nëse nuk ka numërim sekuencial/të vazhdueshëm

Mund të ndodhin gabime në prerje për mallrat që porositen dhe pranohen afër fundit të vitit për të cilat nuk është pranuar ende fatura

Blerja/detyrimi mund të regjistrohet në mënyrë të pasaktë nëse nuk ka kontroll automatike për të parandaluar postimin e faturave që num

Rekomandimi

Inspektimi fizik i pasurive që kanë nevojë të zëvendësohen nga një person i ndryshëm prej atij që bën porosinë

Format nuk duhet të procesohen nëse nuk janë të plotësuar saktë
Ndjekje e vazhdueshme e artikujve të pranuar me ato të porositur

Kryeni numërim fizik të pasurive në baza periodike për të siguruar se të gjitha pasuritë ekzistojnë

Format e fletëpranimeve duhet të jenë të pranumëruara

Duhet të regjistrohen në kontabilitet në momentin e pranimi të mallrave

Duhet të dizajnohet një sistem i cili ruan faturat derisa mospërputhja të zgjidhet por e cila ende lejon që detyrimi të regjistrohet në kontabilitet

Nuk ka procedura të mjaftueshmë për të regjistruar shlyerjet e pasurive që nuk përdoren	përputhen me fletëpranimit Kjo po ashtu mund të shkaktoj pagesa të pasakta të faturave Mos-aszhurnimi i listës së pasurive dhe librit kryesor me kohë për artikujt që zëvendësohen mund të shkaktojë mbivlerësim të pasurive	Themelimi i një procesi formal që identifikon çfardo shlyerje nga lista e pasurive dhe libri kryesor
---	--	--

(c) Testet e kontrolleve përdoren për të siguruar se kontrollet e entitetit operojnë si duhet nëse auditori mund të mbështetet në kontrollet e entitetit, kjo mund të shkaktojë zvogëlim të testeve thelbësore.

(d)

Mbajta e listës së pasurive

Ndarja e detyrave në mes të personave që bëjnë kërkesën dhe atyre që bëjnë porosinë

Porositë jaën të paranumëruara

Porositë aprovohen

Përputhja e porosove me fletëpranim dhe faturë

Harmonizimi i listës me librin kryesor dhe aprovimi nga drejtori financiar

Detyra 4

Ju jeni auditor në firmën e auditimit Vilma-Audit dhe kjo është hera e parë që jeni duke punuar në auditimin e një klienti të firmës, Zana Shpk. Aktiviteti kryesor është ofrimi i këshillimeve për investime për individ lidhur me kursimet nga përsionet, blerja e aksioneve dhe letrave me vlerë dhe investimin në skema tjera investuese. Zana rregullohet nga autoritete relevante të shërbimeve financiare të Bankës Qendrore të Kosovës.

Nga ju është kërkuar të filloni planifikimin e auditimit të Zana Shpk nga Zt. Beni, partner i auditimit në Vilma-Audit. Zt. Beni ka qenë partner i angazhimit për Zana në nëntë vitet e kaluara prandaj ka një njohuri të shkëlqyer për klientin. Ai ju ka informuar se do të dëshironte që djali i tij Rroni të jetë pjesë e ekipit të auditimit këtë vit. Rroni aktualisht është duke përfunduar provimet e certifikimit në ShKÇAK. Zt Beni po ashtu ju ka treguar se seniori i auditimit, Tomorri ka pranuar këshilla për investime nga Zana Shpk dhe ka për qëllim që edhe vitin e ardhshëm të merr këshilla të tilla.

Në takimin fillestar me drejtorin e ri financiar të Zana Shpk, ju keni mësuar se ekipi i auditimit nuk do të argëtohet në jahtin e Zana Shpk, ashti siç kishin bërë vitin e kaluar. Ai beson se kjo mund të shihet si ndikim mbi punën e auditorëve dhe opinionin e tyre, prandaj ai ka arranzhuar që të blen bileta për finalen e kupës së futbollit për tërë ekipin e auditimit. Pasi që kostoja e këtyre biletave është dukshëm më e ulët se argëtimi në jahtë kjo mund të jetë e pranueshme për auditorët. Drejtori po ashtu deklaroi se tarifa për shërbimet e tatimeve për këtë vit duhet të bazohet mbi përqindjen e tatimeve të kursyera. Ai beson se firma juaj do të pranojë një tarifë fikse në përfundimin e Zana Shpk lidhur me një mosmarrëveshje me autoritetet tatimore për një tatim të pagueshëm. Përveç kësaj, Zt Beni ju ka informuar se Zana Shpk është në proces të themelimit të komitetit të auditimit në mënyrë që të përmirësojnë marrëdhënien në mes të funksionit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni kërcënimet etike të cilat ndikojnë në firmën tuaj të auditimit, si auditor të Zana Shpk. (6 pikë)

(b) Për secilin kërcënim etik, diskuto se i mund të zvogëlohet efekti i kërcënimit. (6 pikë)

(c) Shpjegoni si mund të ndihmojë komiteti i auditimit në marrëdhënien në mes të auditorit të jashtëm dhe kompanisë.

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

Kërcënimi etik

Partneri i angazhimit është auditor i kompanisë në 9 vitet e fundit. Ky është kërcënim i shoqërimit të gjatë me klientin që mund të kërcënoj objektivitetin e auditorit

Nuk ka ndonjë parim etik që ndalon përfshirjen e djalit të partnerit në auditim. Mirëpo, mund të duket se ka mungesë të pavarësisë pasi që Rroni është djali i partnerit të angazhimit. Rroni mund të mos ushtrojë detyrën me objektivitet duke mbrojtur interesin e të atit.

Për deri sa Tomorri ka paguar në tërësi tarifën për këshilla investive, nuk duket që ka ndonjë kërcënim etik. Ky do të ishte transaksion normal komercial në mes të dy palëve. Mirëpo nëse këto këshillime merren pa pagesë ose me pagesë më të ulët se çmimi i zakonshëm, kjo do të përbënte kërcënim të pavarësisë për shkak të interesit financiar

Ekipit të auditimit u janë ofruar biletat për finalen e kupës së futbollit. Pranimi i dhuratave nga klienti, përveç nëse kanë një vlerë shumë jomateriale, nuk lejohet. Edhe pse biletat kushotjnë më lirë se argëtiminë jahtë, pavarësia ende mund të jetë e kërcënuar.

Në auditori pajtohet të pranojë tarifën për shërbime të tatimit si përqindje të tatimit të kursyer, është tarifë kontingjente. Mund të ketë presione për të fituar sa më shumë tatim të rimbursueshëm që mund të çoj firmën e auditimit të përdorë skema të palejuara të shmangies nga tatimet.

Përfaqësimi i klientit në gjykatë mund të shihet si kërcënim i avokimit – firma e auditimit e promovon pozitën e klientit. Në këtë rast objektiviteti i auditorit do të komprometohej.

Shmangia dhe masat mbrojtëse

Duhet të zëvendësohet partneri i auditimit.

Për të qenë i pavarur plotësisht, Rroni nuk duhet të jetë pjesë e ekipit të auditimit. Mirëpo nëse partneri i angazhimit zëvendësohet, atëherë përfshirja e Rronit në ekip nuk do të përbënte kërcënim etik.

Për të treguar se është i pavarur nga klienti, duhet kërkuar nga Tomorri të mos përdorë shërbimet e klientit.

Nuk duhet të pranohen biletat e ndeshjes së futbollit. Gjithashtu duhet të hetohet rasti i vitit të mëparshëm kur ekipi i auditimit është argëtuar në jahtin e klientit.

Firma e auditimit duhet të konfirmojë se asistencë rreth tatimeve mund të jetë e pranueshme, mirëpo nuk mund të pajtohen që komenzimitë bazohet në tarifa kontingjente.

Firma e auditimit duhet të refuzoj përfaqëimin e klientit në gjykatë.

(c) Komiteti i auditimit mund të asistojë në disa fusha:

- Ndihmojë të shmangien e dyfishimit të punës nga auditorët e brendshëm dhe të jashtëm
- Rishikimi i gjetjeve nga auditimi dhe fushat me rrezik më të lartë

- Qartësimi i çfado problemi lidhur me trajtimet më të përshtatshme kontabël
 - Të vepruarit si ndërmjetës kur ka çështje që duhet sqaruar në mes të auditorit të jashtëm dhe të brendshëm dhe bordit
 - Monitorimi i përzgjedhjes së auditorit të jashtëm dhe kompenzimit të auditorit
 - Ofrimi i qasjes tek komiteti i auditimit për diskutimin e çështjeve që mund të jenë të ndjeshme ndaj disa antërëve të menaxhmentit
 - Vepron is kanal i komunikimit në mes të bordit dhe të dy auditorëve, të jashtëm dhe të brendshëm.
- Zgjidhja e çështjeve të pavarësisë së auditorit të jashtëm

Detyra 5

Kompani Rent-A-All operon nga 12 depo që ofrojnë makineri të rënda me qira në tërë vendin. Kompania ofron makineri për ndërtimtari dhe konsumatorë tjerë me afat pagese ndërsa për konsumatorët individual me parapagim, përfshirë pagesa me para të gatshme. Përveç të hyrave të gjeneruara nga dhënia me qira e makinerive, kompania po ashtu gjeneron të hyra nga shitja e makinerisë së vjetëruar dhe të dëmtuar si dha nga dhënia me qira e pajisjeve të vogëla të sigurisë.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni në mënyrë kritike TRE faktorë të cilët mund të ndikojnë në rritjen e rrezikut të vetëvetishëm që kanë të bëjnë me të hyrat nga dhënia me qira e pajisjeve ta paraqitura në pasqyrat financiare të kompanisë. (12 pikë)

(b) Çka nënkuptohet me:

- (i) Rreziku i auditimit
- (ii) Rreziku i vetëvetishëm
- (iii) Rreziku i kontrollit
- (iv) Rreziku i moszbulimit. (6 pikë)

(c) Shpjegoni çka do të thotë termi 'dëshmi e auditimit' dhe rëndësinë e saj në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare. (2 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

1 Regjistrimi i vlerës së shitjeve nga transaksionet e kompanisë

Vet natyra e shërbimeve të kompanisë paraqet vështirësi për tu siguruar se të gjitha transaksionet janë regjistruar me vlerë të saktë. Me siguri që transaksionet e dhënies me qira të makinerive bazohen në tarifa ditore. Pasi që kemi të bëjmë me qira, nuk ka transferim të pronësisë tek blerësit.

2 Regjistrimi i vlerës së shitjeve që i atribuohet pajisjeve të sigurisë

Ekziston një rrezik i lartë i vetëvetishëm në të hyrat nga dhënia me qire e pajisjeve të sigurve. Ngjashëm me pikën 1 më sipër, edhe këto transaksione përfshijnë vetëm bartjen e përkohshme të pronësisë në këmbim të pagesave. Ka mundësi të madhe që transaksionet të pëmbajnë gabime ose të ngarkohen me qëllim më çmime tjera.

3. Shtrirja gjeografike e depove të kompanisë

Shkalla e operacioneve të kompanisë tregon se kemi të bëjmë me një kompani relativisht të madhe prandaj ka gjasë që të ketë numër të madh të transaksioneve. Ky fakt, i kombinuar me mundësinë e numërit të madh të të punësuarve që bashkëveprojnë me konsumatorët e kompanisë, rritë rrezikun e gabimeve në transaksione

4 Transaksionet me para të gatshme

Kompania pranon pagesa me para, si rezultat vetë paraja përmban rrezik të madh të vetëvetishëm për shkak të mundësisë së keqpërdorimit.

(b)

(i) Rreziku i auditimit është rreziku që auditori të jep një opinion të papërshtatshëm mbi pasqyrat financiare.

(ii) Rreziku i vetëvetishëm është ndjeshmëria e një pohimi nda anomalive material duke supozuar se nuk ekzistojnë kontrollet përkatëse për ta parandaluar ose zbuluar anomalinë.

(iii) Rreziku i kontrollit është rreziku që një anomali material mund të ndodhë dhe mund të mos zbulohet ose parandalohet nga kontrollet e entitetit.

(iv) Rreziku i moszbulimit është rreziku që procedurat e auditimit të auditorit nuk do të zbulojnë anomalinë materiale

(c) Dëshmia e auditimit janë të gjitha informatat e përdorura nga auditori për të arritur në një konkluzion mbi të cilin e bazon opinionin. Dëshmitë e auditimit duhet të jenë të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe mbi ato të bazohet opinion i auditimit.